


Rritja e numrit të të vaksinuarve në Kosovë – faktorët determinues në këtë proces

Numri i lartë i rasteve me COVID-19 në Kosovë dhe numër i ulët i vaksinimit

Rastet e para me COVID-19 në Kosovë janë regjistruar në mars të vitit 2020. Numri më i madh i rasteve pozitive është shënuar më 26 gusht 2021, ku janë shënuar 1,118 raste pozitive me COVID-19. Arsyea kryesore e rritjes së numrit të rasteve gjatë kësaj kohe ishte lirimi i masave kundër COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajve të verës së vitit 2021. Për shembull, ishte lejuar grumbullimi në hapësira të mbyllura deri 100 persona, lejimin e organizimit të dasmave, ahengjeve etj. Gjatë kësaj periudhe, Kosova është karakterizuar në njërën anë me numër të madh të të infektuarve dhe vdekjeve nga COVID-19, në anën tjetër me numër të vogël të të vaksinuarve krahasuar me vendet e rajonit.




FIGURA 1: Numri i rasteve me COVID-19 në Kosovë, Serbi, Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri që nga fillimi i pandemisë



Burimi: Our World in Data:
Coronavirus (COVID-19)
Vaccinations - Statistics
and Research

Në figurën 2 më poshtë është paraqitur grupimi i personave të vaksinuar në Kosovë dhe në vendet fqinje me një apo dy doza, që nga fillimi i vaksinimit deri më 23 gusht 2021.

FIGURA 2: Trendi (shprehur në %) i personave të vaksinuar me një dhe dy doza kundër COVID-19 në Kosovë dhe vendet e rajonit




Burimi: Our World in Data:
Coronavirus (COVID-19)
Vaccinations - Statistics
and Research

Pra, siç vërehet nga figura 2, Kosova ka qenë e fundit në krahasim me vendet tjera sa i përket numrit të të vaksinuarve nga COVID-19.

Rritja e theksuar e numrit të personave të vaksinuar dhe rënia e numrit të rasteve me COVID-19 në Kosovë

Nga fundi i gushtit e deri më datën 15 nëntor 2021 është shënuar një rritje e theksuar e numrit të personave të vaksinuar në Kosovë. Kjo ka ndikuar që Kosova nga vendi i fundit në rajon, të del e para më shumë të personave të vaksinuar. Nga fundi i gushtit deri më 15 nëntor 2021, numri i personave të vaksinuar me dozën e parë ka qenë 95,566 ndërsa numri i personave të vaksinuar me dozën e dytë 75,136.

FIGURA 3: Trendi (shprehur në %) i personave të vaksinuar me një dhe dy doza kundër COVID-19 në Kosovë dhe vendet e rajonit



Burimi: Our World in Data:
Coronavirus (COVID-19)
Vaccinations - Statistics
and Research

FAKTORËT APO ARSYET QË KANË NDIKUAR NË RITJEN E NUMRIT TË TË VAKSINUARVE NË KOSOVË GJATË PERIUdhËS - FUNDI I GUSHTIT DERI ME 15 NËNTOR 2021 JANË¹:

1. Rritja e kapaciteteve vaksinuese nga 90 ekipe sa ishin në fillim të pandemisë në mbi 300 sosh e po ashtu rritje e numrit të dozave të vaksinës. Rritja e kapaciteteve të vaksinimit ishte paraparë edhe me [Planin e veprimit për vaksinimin e qytetarëve në masë me vaksinën kundër COVID-19](#), hartuar në maj 2021, që parashihnte vaksinimin e rreth 500,000 qytetarëve brenda muajit. Si rezultat i sigurimit të mjaftueshëm të dozave të vaksinës, janë shpërndarë doza të mjaftueshme në çdo pikë të vaksinimit e shoqëruar edhe me rritjen e ekipeve për vaksinim (përfshirë ekipet mobile).
2. Është zhvilluar fushatë më e drejtpërdrejt për të motivuar popullatën për vaksinim. Kjo fushatë ishte e nevojshme për shkak të hezitimit të shfaqur nga qytetarët për t'u imunizuar me vaksinën kundër COVID-19. Gjatë kësaj kohe, Ministria e Shëndetësisë (MSH) përmes rrjeteve sociale ka bërë thirrje tek qytetarët që të vaksinohen, duke treguar të dhënat shkencore që tregojnë dobritë e vaksinimit. Po ashtu, MSH ka realizuar video motivuese me persona që kanë ndikim, duke treguar arsyet e vaksinimit dhe efektin që ka vakcina. Një element tjetër i fushatës motivuese për vaksinim nga ana e MSH-së është edhe dërgimi i mesazheve përmes telefonave tek qytetarët që të vaksinohen edhe pa termin.

¹ Faik Hoti. Komunikim përmes email-it. 15.11.2021.

3. Frika e popullatës nga përhapja ekstreme e variantit delta gjatë muajit korrik-gusht 2021 (me prezencë në 98% në rastet e detektuara të COVID-19 me këtë variant) deri në 2,500 raste në ditë dhe me numër të lartë të vdekjeve. Përhapja e këtij varianti ka ndikuar që gjatë këtyre muajve të rritet numri i të vaksinuarve duke shkuar deri më 19,526 brenda ditës. Po ashtu vaksinimi i madh i qytetarëve gjatë kësaj kohe ka ndikuar që të ulet numri i rasteve pozitive sa ishte në gusht 2,250 brenda ditës, në 259 raste në muajin shtator.
4. Paralajmërimet e Qeverisë rreth qasjes së zyrtarëve në institucione, dhe në veprimtari të tjera, si dhe liria e lëvizjes në njëfarë forme do ta varej nga statusi i të vaksinuarit. Sipas vendimit të qeverisë nga 20 gushti i vitit 2021, hyrja në ambiente ku mbahen grumbullime, aktivitetet kulturore ose sportive u lejua vetëm nëse personi ka dëshmuar që ka kartë të vaksinimit ose testin RT-PCR negativ për COVID-19. Këto masa ndikuan në rritjen e vetëdijes së qytetarëve për vaksinim, duke ndikuar në rritjen e numrit të të vaksinuarëve.
5. Paralajmërimet nga vendet e ndryshme në Evropë dhe më gjerë që liria e lëvizjes do të varet nga vaksinimi, sikurse edhe aplikimi për viza. Gjatë marsit të vitit 2021, Bashkimi Evropian (BE) kishte vendosur kufizime për të gjitha udhëtimet. Një nga këto kufizime ishte pajisja me certifikatë digjitale të BE-së, e cila në rast se nuk sigurohej personi duhej testuar ose karantinuar. Një certifikatë e tillë digjitale është diskutuar të kërkohet edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor². Një kufizim i tillë i lëvizjes ka qenë një element shtesë që ka shtyrë qytetarët që synojnë shtetet e Evropës, që të vaksinohen.
6. Para fillimit të vitit të ri shkollor, sidomos gjatë dy javëve të para të muajit shtator, ishte bërë thirrje që vaksinimi i mësimdhënësve para fillimit të vitit shkollor si dhe qasja e studentëve në biblioteka me dëshmi të vaksinimit ishte kushtëzuar me procesin e vaksinimit. Gjatë qershorit të vitit 2021 kishte hezitim nga ana e mësimdhënësve që të vaksinoheshin, mirëpo thirrja për vaksinim nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe paralajmërimi se vaksinimi është parakusht i fillimit të procesit mësimor³ ka bërë që të rritet përqindja e mësimdhënësve të vaksinuar nga 30% gjatë muajit korrik, në 90 %⁴ gjatë muajit tetor. Po ashtu, ndalimi i hyrjes në biblioteka pa pasur dëshmi të vaksinimit ka ndikuar në rritjen e numrit të të vaksinuarve.
7. Faktorët e lartpërmendur kanë ndikuar në rënien e numrit të personave që kanë dyshime në vaksinim (apo anti-vaksinera) dhe rrjedhimisht ka afektuar rritjen së numrit të të vaksinuarve. Sipas hulumtimeve të perceptimeve të MSH-së rreth perceptimeve për vaksinën (tetor 2020), gradualisht ka ardhur duke rënë numri i atyre që kanë rezerva ndaj vaksinës, nga në rreth 50% që kanë qenë pothuaj kundër vaksinimit në tetor-nëntor 2020, në rreth 18% në qershor-korrik 2021⁵.

Në bazë të faktorëve të përmendur si më lartë, mund të përfundohet që veprimet e marra nga MSh kanë pasur ndikim në rritjen e theksuar të numrit të personave të vaksinuar dhe në të njëjtën kohë, uljen e numrit të rasteve dhe vdekjeve nga COVID-19. Megjithatë, për të pasur një rezultat afatgjatë apo të qëndrueshëm në menaxhimin e pandemisë, masat e marra duhet të aplikohen në mënyrë konsistente për shkak se rreziku nga përhapja e varianteve të reja të COVID-19 në Kosovë dhe më gjerë është shumë real.

2 Radio Evropa e Lirë. "Certifikatat e vaksinimit do t'iu lëshohen edhe qytetarëve të Ballkanit Perëndimor". 29 mars 2021. <https://dpl.us/no3>. (qasur për herë të fundit më 3 nëntor 2021).

3 K. E. "Vetëm 30 për qind e mësimdhënësve janë vaksinuar". Kosova Sot. 27 korrik 2021. <https://dpl.us/s1t>. (qasur për herë të fundit më 1 nëntor 2021).

4 Ahmeti, Gentiana. "MASHT: 90% e mësimdhënësve janë vaksinuar". Kallxo.com. 1 tetor 2021. <https://dpl.us/i0t>. (qasur për herë të fundit më 3 nëntor 2021).

5 Faik Hoti. Komunikim përmes email-it. 15.11.2021.

